



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.198/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit “T...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” – Prishtinë kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e Aktvendimit, me objekt kontesti kundërvajtje doganore – klasifikim tarifor, vlerë kontesti 750.00€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor-kryesor publik, të mbajtur me datë 11.10.2022, në prani të autorizuarit të palës paditëse G.B nga Shoqëria e Avokatëve “...”, dhe të autorizuarit të palës së paditur B.G, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit ““T...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson G.B nga Shoqëria e Avokatëve “...” – Prishtinë, në tërësi si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 01.3.2.2/20482 i datës 24.11.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 31.12.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke kërkuar

anulimin e Aktvendimit nr. 01.3.2.2/20482 të datës 24.11.2021, të paditurës Dogana e Kosovës, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të Kodit Doganor Ligjit për Produkte Medicinale dhe vendimit mbi gjobën, dhe ka kërkuar nga gjykata të aprohet si e bazuar në tërësi padia e paditësit dhe të anulohet në tërësi vendimi kontestues. Përfaqësuesja e palës paditëse si në padi, në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: paditësi e ka deklaruar mallin sipas numrit tarifor 9018908400 e cila ka të bëjë me pajisjet mjekësore, përkatësisht në kapitullin 90 të TARIK, ndërkohë që e paditura sipas mendimit të saj ka ardhur në përfundimin se malli lëndor nuk mund të jetë i përfshirë në kapitullin 90 të lartpërmendur, por në kapitullin 94 ku përfshihen mobilierit, krevatet, llambat dhe pajisje ndriçimi etj. Është fakt që malli lëndor është llambë, por ajo nuk është një llambë e cila mund të përdoret në përdorim të përditshëm, por është llambë specifike e cila përdoret vetëm në fushën e mjekësisë. Vetëm duke e parë me të cilin është deklaruar malli, shihet qartë se ky mall nuk ka qenë një mall i zakonshëm ashtu siç pretendon e paditura. Gjithashtu për importin e këtij malli paditësi ka kërkuar nga AKPM, dhe në licencën për import të lëshuar nga ky institucion për këtë mall, është cekur edhe numri i Pro Faturës me të cilën është bërë edhe porosia e këtij malli. Tutje deklaroi se eksportuesi i këtij malli është prodhues ekskluzivisht i pajisjeve mjekësore, dhe kjo mund të vërtetohet lehtë edhe në hulumtimet në internet. Gjithashtu, paditësi mallin lëndor ia ka shitur një subjekti “E...” Sh.P.K, me seli në Gjakovë si pajisje medicinale, pasi që kjo pajisje është e destinuar vetëm për sallat e operacionit, dhe një kopje të së cilës ia paraqesim gjykatës dhe palës paditëse. Nga sa u tha edhe bazuar në provat e kësaj lënde, kërkon nga gjykata aprovimin e padisë dhe kërkesëpadisë si të bazuar, dhe anulimin e vendimit kontestues, duke obliguar të paditurën që paditësit t’ia kthejë shumën prej 750.00€, të paguar në emër të gjobës doganore. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 28.03.2022, e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi është marrë komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë komfor legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj i propozojmë gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe

kërkesëpapia e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e paditura ka deklarua se: Dogana ka vepruar drejtë kur ka shpallur përgjegjës paditësin si në aktvendimin kontestues, pasi që kjo përmes Deklaratës Doganore R-81596/15.010.2021 gjatë kontrollës doganore nuk e ka deklaruar saktë numrin tarifor, dhe si rezultat i mos deklarimit të saktë të Kodit Doganor dhe duke pasur një mendim mbi klasifikimin tarifor që është lëshuar nga një Sektor Profesional të Doganës së Kosovës, dhe paditësi mbi bazën e kësaj për deklarim të pasaktë të Kodit Tarifor ka vepruar në kundërshtim me nenin 276 pika k) të KDA-së. Po ashtu, i kundërshtojmë pretendimet e palës paditëse sa i përket dokumentit të AKPM-së, duhet t'i sqarojmë sepse për futjen e mallrave në vendin tonë pa një licencë të tillë nuk do të mund të importoheshin, dhe se ky dokument nuk e përcakton saktësinë e Kodit Tarifor, dhe vetëm Dogana është agjenci ekzekutive që kontrollon mallrat me rastin e importit dhe harmonizimin e tyre me gjendjen faktike të mallit. Shumë qartë jepen sqarimet si në mendimin për klasifikim tarifor Nr.110/15.10.2021, dhe mbesim pranë të gjitha sqarimeve të dhëna si në arsyetimin e vendimit kontestues të nxjerrë nga Dogana e Kosovës. Bazuar në thëniet e cekura si më lartë, e paditura i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pa bazuar padia dhe kërkesëpapia e paditësit, dhe ta lenë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 11.10.2022, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimet Nr.20482/24.11.2021, Nr.2021-1395/18.10.2021, Shënimet nga TARIK kapitulli 90 dhe 94, DUD-at R-81596/15.10.2021, Faturat Nr.5720/09.10.2021, Nr. EAE2021000000022, Nr.1-3158/22.10.2021, Deklarata EX1 e datës 06.10.2021, CMR nr.0308744, Licenca nga AKPM, A-4935/21 së bashku me aplikacionin për pajisje medicinale, Pagesa Bankare e datës 18.10.2021 së bashku me Urdhërpagesën, Pro Faturat e datës 27.08.2021 dhe 10.08.2021, Përgjigja në Padi e datës 28.03.2022, Procesverbali i datës 24.11.2021 i Doganës së Kosovës, Mendimi për Klasifikim Tarifor Nr.110/15.10.2021, Procesverbali mbi Kundërvajtjen Doganore i datës 15.10.2021, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës Nr.20482/20.10.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në ankesë/padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklaratimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi me anë të DUD-it R-81596/15.10.2021, ka paraqitur mallin lëndor për zhdoganim, me ç ‘rast i njëjti është proceduar, por duke u ri-klasifikuar nga Sektori për Kontroll Pas Importuese në kod tjetër tarifor. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi është dënuar me gjobë për deklarim të pa saktë të kodit tarifor të mallit me aktvendimin nr. 03.1.7-2021-1395 të datës 18.10.2021, nga Sektori për Kundërvajtje Doganore, dhe i njëjti ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 24.11.2021, ka sjell Aktvendimin nr. 20482, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, për rishqyrtimin e aktvendimit 03.1.7-2021-1395 të datës 18.10.2021, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 21.12.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura me aktvendimin kontestues e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e Aktvendimit nr. 03.1.7-2021-1395 të datës 18.10.2021. E paditura ka vlerësuar se sektori për kundërvajtje doganore ka vepruar drejtë kur ka shpallur përgjegjës paditësin si në aktvendimin kontestues, kjo pasi që me datë 15.10.2021 në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 1, përmes deklaratës doganore R-81596/15.10.2021, paditësi nuk ka deklaruar saktë numrin tarifor 9018908400, për mallin “pajisje për sallat të operacionit (reflektor) që përdoret në spital “Pergamon + 661X/661X Double Led Surgical Light”, kjo edhe sipas mendimit të Sektorit të Tarifës nr.04.1.2.110/1510.2021, e ka shpallur përgjegjës këtu

paditësin, bazuar në nenin 276, pika k), e KDA-së, duke i shqiptuar gjobë në të holla në shumën prej 1,500.00€. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet tjera të paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, sipas procesverbalit të Doganës së Kosovës të datës 15.10.2021, dhe sipas Mendimit mbi klasifikim tarifor nr. 04.1.2/110-15.10.2021, Dogana e Kosovës ka konstatuar se subjekti "T..." Sh.P.K. me seli në Prishtinë, kontrollit Doganor nuk i ka deklaruar saktë kodin tarifor të mallit për mallin e deklaruar me anë të deklaratës doganore R-81596/15.10.2021 e ka deklaruar mallin në kodin tarifor ... që e liron nga taksat doganore, ndërsa sipas mendimit mbi klasifikim tarifor nr. 04.1.2/110-15.10.2021, i njëjti mall duhet të deklarohet në kodin tarifor ... dhe se duhet të paguaj detyrime doganore në vlerë prej 1,310.67€, andaj edhe duke vepruar në këtë mënyrë pra me qëllim që të paguajë taksa doganore në vlerë më të vogël se sa ajo reale, ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 276 paragrafi k) të Kodit Doganore dhe të Akcizave të Kosovës, me ç'rast këtu paditësi nga Sektori për Kundërvajtje Doganore me Aktvendimin nr. 03.1.7-2021-1395 të datës 18.10.2021, është dënuar me gjobë prej 1,500.00€. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Pretendimin e paditësit se për mallin në fjalë është marr licenca për import nga AKPPM, i cili është organ kompetent për produkte medicinale dhe këtë mall e ka trajtuar si produkt medicinal, Gjykata nuk e pranon si të drejtë për faktin se Dogana e Kosovës është organi i

vetëm kompetent e cila vendos për kodet tarifore dhe duke i pasur parasysh dispozitat ligjore të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku shprehimisht parashihen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore e ku në mes tjerash në paragrafin 1, pika C thuhet; *“Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruar”*, konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura por edhe para gjykatës të ofrojë prova konkrete për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar, për vendosje të mallit lëndor në qarkullim të lirë, gjë të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë, e sidomos në rastet kur në kodin tarifor të deklaruar sipas TARIK-ut aplikohet lirime nga detyrimet doganore. Pra, Gjykata konstaton se dokumenti i vetëm kyç që provon pretendimin e paditësit lidhur me klasifikimin tarifor të mallit ndryshe nga ajo që është konstatuar me mendimin tarifor 04.1.2.110/15.10.2021, nga e paditura është Informata Tarifore Detyruese e lëshuar nga autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian, dhe për më tepër lidhur me Informatën Tarifore Detyruese të BE-së, është deklaruar më kërkesë të Gjykatës edhe vet përfaqësuesja e autorizuar e palës paditëse dhe e cila në seancën kryesore thekson se : *“BTI ose Informata Tarifore detyruese nuk është në shkresat e lëndës”*.

Gjykata ka gjetur si jo të bazuar edhe pretendimin e fundit të këtu paditësit lidhur me faktin se paditësi ka mjetueshëm dokumente të cilat vërtetojnë kodin tarifor, për arsye se e paditura, për DUD-in kontestues R-81596/15.10.2021, ka kërkuar mendim për klasifikim tarifor nga Sektori i Tarifës po në kuadër të Doganës, e i cili Sektor me datë 15.310.2021, ka lëshuar mendimin për klasifikim tarifor nr. 110, e sipas të cilit mendim, kodi tarifor i deklaruar nga këtu paditësi nuk është i duhuri dhe se kodi tarifor i duhur është 9405409900, kjo bazuar në rregullat e përgjithshme të interpretimit 1 dhe 6 për interpretimin e TARIK-2021, shënimet shpjeguese të nomenklaturës së kombinuar të kreut 9405. Gjykata konstaton se dokumenti i vetëm kyç që provon pretendimin e paditësit lidhur me klasifikimin tarifor të mallit është Informata Tarifore Detyruese e lëshuar nga Bashkimi Evropian aplikuar përshtatshmërisht siç përcaktohet me nenin 18, të KDA-së, Kodi 03/L-109, e të cilin dokument këtu paditësi ka dështuar ta prezantoj.

Neni 43, par 1. i LKA-së, “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”, andaj paditësi në këtë konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat dhe atë informatën tarifore detyruese lidhur me klasifikimin tarifor të mallit për DUD-in kontestues, e me të cilat do të mbështeste pretendimet e tij si në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të Padisë

Nuk është kontestues fakti se e paditura mund të kontrolloj deklaratat pas zhdoganimit, kjo ngase neni 82, i KDAK-së përcakton shprehimisht një të drejtë të tillë, dhe atë në paragrafin 1. Ku thuhet se “Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimit të mallit”, pastaj paragrafin 2. “Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur” dhe në paragrafin 3. Ku thuhet se: “Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmerr masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata komfor dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.198/22 datë 11.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.